

## **INSTITUTI I AVOKATIT- ROLI I TIJ PËR NJË PROCES GJYQËSOR TË DREJTË DHE TË PAANSHËM**

Dr. Juliana LATIFI\*

### **Abstrakt:**

*Mbrojtja e të drejtave të individit, zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, do të mund të sigurohet më mirë nëpërmjet ndihmës juridike, që avokati, si përfaqësues i interesave të ligjshme të individit i siguron atij.*

*Pavarësia e avokatit është aq e nevojshme për të besuar në procesin e drejtësisë dhe në paanshmërinë e gjyqtarit. Avokatia dhe gjyqësori, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, do të sigurojnë standarde dhe respektim të të drejtave të individit në shoqëri.*

*Reforma në drejtësi kërkon edhe reformim të institutit të avokatisë, ku avokati në ndihmë të gjykatës, me profesionalizëm dhe ndershmëri, duke zbatuar dhe respektuar ligjet në fuqi, si dhe Kodin e Etikës së Avokatit duhet t'i shërbejë dhënies së drejtësisë, dhe forcimit të shtetit ligjor.*

*Vetëm një institut avokatie i reformuar sipas standardeve ndërkombëtare, do të mund të realizojë një ndihmë ligjore adekuate, dhe të mbështesë gjykatën që të gjykojë me drejtësi.*

**Fjalët kyç:** *Avokatia, gjykatat, individi, reforma e sistemit të drejtësisë, integrimi i Shqipërisë.*